



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



MONITORIMI I FUSHATËS PËR RIVOTIM NË KOMUNËN E ISTOGUT

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nga të licencuarit. Në Kreun VIII të këtij Ligji, i cili vlen edhe për Zgjedhjet Lokale, janë të përcaktuara në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat Gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”.

Me qëllim të përmbushjes së këtij obligimi, KPM ka vazhduar monitorimin e fushatës për rivotim në Komunën e Istogut.

Monitorimi i ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale (OSHMA) të cilët kanë mbuluar fushatën për rivotim në Komunën e Istogut, kishte për qëllim vlerësimin e performancës së OSHMA-ve në pajtim me dispozitat e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Monitorimi është bërë për periudhën kohore prej 11 deri më 17 dhjetor 2017, prej orës 16:00 deri në orën 24:00.

Në monitorim janë përfshirë: OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional (RTK1, TV21 dhe KTV), lokal/regjional (TV DUKAGJINI dhe TV SYRI VIZION) si dhe OSHMA-të me program gjeneralistik, të cilat operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RROKUM TV, TRIBUNA CHANNEL dhe KLAN KOSOVA).

Raporti prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës pesë (5) ditore si dhe heshtjes zgjedhore.

Të gjeturat nga monitorimi dëshmojnë se prezantimi i fushatës për rivotim në Istog ishte kryesisht korrekt dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media, të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Gjatë fushatës, KPM ka udhëzuar OSHMA-të që pas përfundimit të zgjedhjeve të ofrojnë Ditarët në të cilët regjistrohet koha e emetimit dhe ekspozimeve tjera të OSHMA-ve, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë të aktiviteteve të fushatës për secilin kandidat ose SCP. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë procesin e rivotimit në Istog.

Për të parin e Istogut kanë garuar: Haki RUGOVA, kandidat i SCP-së LDK, dhe Gani DRESHAJ, kandidat nga SCP AAK.

I. BAZA LIGJORE DHE METODOLOGJIA

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit. Vlerësimi i pajtueshmërisë me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për “Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve”, ishte fokus i monitorimit të OSHMA-ve të cilat kanë mbuluar këtë fushatë zgjedhore.

Edhe në këto zgjedhje, metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës së dedikuar për kandidatët e SCP-ve pjesëmarrëse në garë. Gjithashtu, është bërë edhe dizajnimi i tabelave për futjen e të dhënave si dhe vlerësimi i prezantimit të fushatës në edicionet e lajmeve, kronika zgjedhore, intervista e debate të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Po ashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës).

II. GJETJET NGA MONITORIMI

Monitorimi pesëditorë i fushatës për rivotim në Istog ka dëshmuar se OSHMA-të kanë raportuar kryesisht në mënyrë të drejtë dhe korrekte, në pajtim me Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

Duke pas parasysh se kandidatët garues për të parin e Istogut dhe subjektet e tyre politike kanë pasur mundësi dhe hapësirë të shpalosin programet e tyre politike në dy runde të Zgjedhjeve Lokalet 2017, konsiderojmë se edhe në procesin e rivotimit, OSHMA-të e monitoruara kanë mbuluar përmes lajmeve, debateve apo intervistave, fushatën e kandidatëve të SCP-ve garuese. Në rastet kur përkundër ftesës për debat zgjedhor, përfaqësuesit e SCP-ve kanë munguar, televizionet kanë njoftuar shikuesit për mos shfrytëzimin e hapësirës së dhënë.

Nga monitorimi është gjetur se gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, më 16 dhe 17 dhjetor 2017, OSHMA-të e monitoruara kanë vepruar në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht me nenin 52 paragrafin 1 të këtij Ligji “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së.

OSHMA-të gjatë fushatës, kanë transmetuar edhe materiale dhe njoftime nga KQZ-ja lidhur me rrjedhën e procesit zgjedhor dhe përgatitjet e materialeve për ditën e votimit.

Gjatë periudhës monitoruese, OSHMA-të e monitoruara nuk kanë transmetuar pika reklamuese politike.

Neni 53 i Ligjit për Zgjedhje obligon OSHMA-të të cilat kanë mbuluar fushatën zgjedhore që pas zgjedhjeve të ofrojnë në KPM Ditarët, në të cilët janë të regjistruara koha e emetimit dhe

ekspozimeve tjera për reklamim me pagesë dhe pa pagesë të aktiviteteve të fushatës, për secilin kandidat/SCP.

Për rastet e mos dorëzimit të Ditarëve, gjë që përbën shkelje të nenit të lartpërmendur, KPM në pajtim me nenin 30 të Ligjit për KPM-në do të ndërmarr veprime përkatëse ligjore.

III. ANKESAT

Gjatë periudhës së rivotimit për Zgjedhjet Lokale në Istog, KPM nuk ka pranuar asnjë ankesë lidhur me mbulimin e fushatës zgjedhore.

IV. HAPËSIRA E OFRUAR PËR SCP-të

Të dhënat lidhur me hapësirën e ofruar për SCP-të/kandidatët nga data 11 dhjetor 2017 deri më 15 dhjetor 2017 janë vetëm për periudhën kohore nga ora 16:00-24:00.

Për OSHMA-të të cilat nuk kanë ofruar debate dhe intervista gjatë periudhës së fushatës zgjedhore janë paraqitur tabelat vetëm për hapësirën e ofruar në edicionet e lajmeve dhe kronika zgjedhore.

Hapësira e dhënë në debate është llogaritur edhe për kandidatët e SCP-ve të cilët janë ftuar nga mediat, por që nuk kanë marrë pjesë në debat.

Në edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore dhe debatet/intervistat e transmetuara, OSHMA-të kanë dedikuar këtë hapësirë për SCP-të/ kandidatët:

OSHMA-të me transmetim tokësor me mbulim nacional

RTK1

Televizioni Publik i Kosovës RTK1, gjatë prezantimit të garës elektorale për rivotim në Komunën e Istogut, ka ofruar hapësirë të balancuar për kandidatët në lajme dhe debate. Në përgjithësi, RTK1 ka raportuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit RTK1 nuk ka transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore duke vepruar në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhje “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së.

Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	230	58.52
LDK	163	41.48
Total	393	100.00

Hapësira në debate		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	3017	50.00

LDK	3017	50.00
Total	6034	100.00

TV 21

Gjatë periudhës monitoruese, TV21 nuk ka mbuluar garën e kandidatëve për Kryetar të Komunës në Istog në lajme e as në debate. Në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit nuk ka transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore.

KTV

Gjatë periudhës monitoruese, KTV në lajme ka njoftuar shikuesit për fillimin e fushatës për rivotim në Komunën e Istogut vetëm ditën e parë të fushatës. Gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit nuk ka transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore duke vepruar në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhje “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së.

Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	238	50.00
LDK	238	50.00
Total	476	100.00

OSHMA me transmetim tokësor me mbulim regional e lokal në regjionin e Pejës

TV SYRI VIZION

Gjatë periudhës monitoruese, TV SYRI VIZION nuk ka mbuluar garën e kandidatëve për kryetar të komunës në Istog as në lajme e as në debate. Në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit TV SYRI VIZION nuk ka transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore.

TV DUKAGJINI

Gjatë prezantimit të garës elektorale, TV DUKAGJINI ka ofruar një debat me kandidatët për kryetar të Komunës së Istogut në të cilin për kundër ftesës ka marrë pjesë vetëm kandidati i SCP-së LDK. Hapësira e ofruar është llogaritur e njëjtë për të dy kandidatët. Në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit TV DUKAGJINI nuk ka transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore.

Hapësira në debate		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)

AAK	3099	50.00
LDK	3099	50.00
Total	6198	100.00

OSHMA-të me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes

RROKUM TV

Gjatë periudhës monitoruese RROKUM TV ka transmetuar intervistën e një anëtari të SCP-AAK, pas një reagimi të SCP LDK lidhur me rivotimin në këtë komunë.

Në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit RROKUM TV ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhje, “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së, duke mos transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore.

Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	30	50.00
LDK	30	50.00
Total	60	100.00

Hapësira në intervista		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	3153	100.00
LDK	0	0.00
Total	3153	100.00

TRIBUNA CHANNEL

TRIBUNA CHANNEL në edicionin e lajmeve ka njoftuar vetëm fillimin e fushatës zgjedhore për rivotimin në Istog. Nuk ka transmetuar debate apo intervista ndërsa në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 16 dhjetor 2017 dhe ditën e votimit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhje “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së.

Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	190	51.91
LDK	176	48.09
Total	366	100.00

KLAN KOSOVA

KLAN KOSOVA fushatën zgjedhore për rivotim në Istog e ka mbuluar në mënyrë të balancuar duke ofruar hapësirë të njëjtë në intervistë kandidatëve për kryetar të Komunës së Istogut. Po ashtu, hapësirë e barabartë iu është dhënë kandidatëve edhe në edicionin e lajmeve. Gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhje, “Ndalimi i përfshirjes në Media” dhe Udhëzuesin e KPM-së, duke mos transmetuar asnjë material i cili i takon aktivitetit të fushatës zgjedhore.

Hapësira në edicionet e lajmeve		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	20	45.45
LDK	24	54.55
Total	44	100.00

Hapësira në intervista		
SPC	Koha e përgjithshme (s)	Koha e përgjithshme (%)
AAK	960	50.85
LDK	928	49.15
Total	1888	100.00

PËRFUNDIM:

Duke pasur parasysh faktin se OSHMA-të kanë ofruar hapësirë të mjaftueshme për shpalosjen e programeve politike të kandidatëve garues për të parin e Istogut dhe subjekteve të tyre politike në dy raunde të Zgjedhjeve Lokalet 2017, të gjeturat nga monitorimi tregojnë se OSHMA-të edhe në procesin e rivotimit për Istogun kanë mbuluar fushatën përmes lajmeve, debateve apo intervistave.

19 dhjetor 2017